

01-10-2018



[Signature]

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:048249

Datë: 31.08.2018

Numri i dokumentit: 00111265

P.nr.988/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, si gjykatë e shkallës së parë penale e përbërë nga gjyqtari Ilir Bytyqi si dhe procesmbajtësen Mimoza Shabani, bashkëpunëtore profesionale, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga Fsh. [REDACTED] K. Viti, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II.nr.724-5/16 të dt.25.04.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, në praninë e përfaqësuesit të akuzës - Prokurorit të Shtetit Albert Zejnullahu si dhe të pandehurit [REDACTED], me datë 13.08.2018 mori dhe publikisht komunikoi, kurse me datë 20.08.2018, përpiloi me shkrim këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri: [REDACTED] i lindur me dt. [REDACTED], nga i ati [REDACTED] dhe i nënës [REDACTED] e gjinisë Imeri, me vendbanim ne Fsh. [REDACTED] K. Viti, i martuar, prind i tre fëmijëve, me profesion tregtar, ka te kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 01.05.2016, rreth orës 05:40, ne rrugën magjistrale Prishtine-Ferizaj, përkatësisht përballë "HIB-Petrol" ne Ferizaj, duke drejtuar automjetin e markës "Tata 61" me targë te regjistrimit [REDACTED], duke vepruar ne kundërshtim me dispozitat e nenit 53/1 te

LSKRR-se, duke mos ushtruar kujdës te duhur dhe duke lëvizur me shpejtësi të papërshtatshme prej 125 km/h, me te arritur përball Hib-Petrol, në pamundësi për ta ndaluar automjetin edhe përkundër frenimit, me pjesën e parë të anës së majtë e godet automjetin "Opel Astra" me targe të regjistrimit [REDAKTUAR], në anën e djathtë në derën e pasme të cilin e drejtonte [REDAKTUAR], pasi që i njëjti kishte filluar të ndërmerre veprimin e kycjes përkatësisht kthimin në të majtë për të vazhduar në drejtim të Shkupit e pastaj automjeti Opel Astra kthehet duke u përplasur me rrethojën e pompës ndërsa vetura "Tata 61" kalon jashtë rrugës, ku nga pasojat e kësaj goditje përveç dëmeve materiale të shkaktuara në vetura, lëndime të lehta trupore ka pësuar [REDAKTUAR], të përshkruara në ekspertizën mjeko-ligjore te dt.29.01.2017, ndërsa [REDAKTUAR] nga vërtetimi i Spitalit të Përgjithshëm në Ferizaj edhe pse është evidentuar ne librin e aksidenteve nuk ka qene i evidentuar ne librin e protokollit, pasi kishte lëshuar Spitalin pa e protokolluar Raportin.

me të cilën ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit te sipër cekur dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 46, 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurin e

G J Y K O N

- Me dënim me gjobë në lartësi prej 300 Euro /treqind/, të cilin dënim është i obliguar ta paguajë në afat prej 15 ditëve pasi që aktgjykimi e merr formën e prerë, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.
- Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 46 par. 3 të KPRK-ës, i njëjti do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari për çdo 20 €, do të vuaj një ditë burgimi.
- Të dëmtuarit: [REDAKTUAR], me vendbanim në Rr. "[REDAKTUAR]" nr. [REDAKTUAR] në Ferizaj dhe [REDAKTUAR] me vendbanim në Rr. "[REDAKTUAR]" në Ferizaj ([REDAKTUAR]), për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

- Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 / njëzetë / €, si dhe shpenzimet e procedurës penale expertiza mjeko-ligjore dhe expertiza e komunikacionit në shumën prej 60.88 Euro /gjashtë dhjete euro e tetëdhjetë e tetë cent/, në afatin prej 15 ditëve pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.
- Obligohet i akuzuari që konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m i

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga gjyqtari individual dhe vendi ku është kryer ose tentohet të kryhet vepra penale.

Prokuroria Themelore në Ferizaj me Aktakuzën e saj PP.II.nr.724-5/16 e dt.25.04.2017, ka ngarkuar të pandehurin [REDAKTUAR] nga Fsh. [REDAKTUAR] K. Viti, për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar me dt. 13.08.2018, në të cilën përfaqësuesi i akuzës-prokurori i shtetit, lexoj aktin akuzues, dhe gjyqtari pasi që u bind se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, konform nenit 246 par. 4 dhe përkundër paralajmërimit për nenet 325 dhe 323 të KPPK-së, të pandehurit i ofroj mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

I akuzuarit [REDAKTUAR] në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila iu vihet në barrë sipas të gjitha pikave të saj, ndihet thellë i penduar, i kërkon falje publike të dëmtuarit, këtë vepër penale e ka kryer pa dashje dhe është hera e parë që ndeshet me ligjin dhe e lut gjykatën që ti shqiptoj një dënim sa më të butë, pasi që është mbajtës i familjes, me të dëmtuarin i ka raportet e mira dhe në të ardhmen do të këtë kujdes në komunikacion dhe nuk do të përsërisë vepra të tilla.

Prokurori i shtetit Albert Zejnullahu, me rastin e paraqitjes së mendimit të tij, ka propozuar që të pranohet pranimi i fajësisë për të akuzuarit, pasi pranimi fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare në përputhje me nenin 248 si dhe mbështetet në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPPR-së dhe me këtë rast vlerësoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit si: Ekspertiza e komunikacionit e dt.21.09.2016, Ekspertiza e mjeko-ligjore me nr. reference 12/17 e dt.29.01.2017, Raporti i Aksidentit 2016-cft-241 e dt.01.05.2016, deklarata e të dëmtuarit [REDAKTUAR] deklarata e të pandehurit [REDAKTUAR] e dt.03.05.2016, fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës, si dhe aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore apo faktike.

Me qenë se i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtari individual konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si G.JA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, meqë me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi ku nga pakujdesia në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 54 të LSKRR, e ka rrezikuar trafikun publik duke mos ushtruar kujdes të duhur dhe duke mos lëvizur me shpejtësi të përshtatshme prej 125 km/h, në pamundësi për të ndaluar automjetin edhe përkundër frenimit e godet automjetin "Opel Astra" të cilin ishte duke e drejtuar [REDAKTUAR] ku pos dëmeve materiale, lëndime të lehta trupore pëson e dëmtuara [REDAKTUAR] të përshkruara në Ekspertizën mjeko-ligjore të dt.29.01.2017.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese

përkatësisht që në fillim të shqyrtimit fillestar i pandehuri ka pranuar fajësinë, rrethana lehtësuese pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, vepra ka ndodhur nga pakujdesia dhe nuk ka dëshmi se është i dënuar me vendim të formës së prerë, në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese përveç që vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i akuzuari në të gjitha fazat e procedurës penale ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-ës përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Të dëmtuarit: [REDAKTUAR], me vendbanim ne Ferizaj Rr. [REDAKTUAR] nr [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] me vendbanim ne Ferizaj Rr. [REDAKTUAR], Banesat përballë tregut ditor, [REDAKTUAR] nr [REDAKTUAR], për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 /njëzetë/ Euro, si dhe shpenzimet e procedurës penale ne shumen prej 60.88 € /gjashtë dhjetë euro e tetëdhjetë e tetë cent/ në afatin prej 15 ditëve nga kur aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Obligohet i akuzuari që konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi


Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, P.nr. 988/17 e dt. 20.08.2018

Bashk.Profesionale

Mimoza Shabani

Gjyqtari: Ilir BYTYQI



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit nëpërmjet kësaj gjykate, kurse i dëmtuari mund të paraqet ankesë vetëm sa i përket vendimit për sanksionin penal.